

Vendim nr. 210 datë 29.07.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 29.07.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 11 (M) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **MARK GJERGJI**

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 137, datë 08.09.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës; nr. 1339 (86-2024-1453), datë 16.07.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë; nr. 00-2025-958, datë 03.03.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Shfuqizimi i nenit 6/1 të ligjit nr. 9356, datë 17.03.2005 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë””, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatore n e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Mark Gjergji ka punuar si minator në nëntokë. Ai ka paraqitur kërkesë pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (*DRSSH*) Lezhë për përfitimin e trajtimit të veçantë si minator i nëntokës, duke u bazuar në ligjin nr. 8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë” (*ligji nr. 8685/2000*). Dega e Përfitimeve pranë DRSSH-së, Lezhë, me vendimin nr. 11, datë 30.10.2001, i ka caktuar kërkuesit trajtimin e veçantë si minator në nëntokë (*trajtimi i veçantë*) duke nisur nga data 16.12.2000, në masën 5.148 lekë. Pas kërkesës së tij, me shkresën përcjellëse nr. 1475/3 prot., datë 15.03.2005, dosja është transferuar në DRSSH-në, Durrës.

2. Gjatë kohës që kërkuesi përfitonte trajtimin e veçantë është miratuar ligji nr. 9356, datë 17.03.2005 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”” (*ligji nr. 9356/2005*), nëpërmjet të cilit, ndër të tjera, janë shtuar nenet 6/1 dhe 6/2. Në nenin 6/1 parashikohet se përfitimet nga ky ligj nuk tatohen. Përfitimet e caktuara, sipas këtij ligji, rriten ose indeksohen sa herë dhe në atë masë që rriten ose indeksohen pensionet e pleqërisë nga sigurimi i detyrueshëm shoqëror. Përfitimet e caktuara, por të patërhequra, paguhën në çdo kohë, por jo më shumë se për 1 vit. Përfitimet e caktuara, por të paguara më pak, jepen në çdo kohë, por jo më shumë se për 1 vit. E drejta për të kërkuar shumat e marra tepër gjatë një viti ushtrohet jo më vonë se 3 vjet nga marrja e tyre, por jo më vonë se 6 muaj nga data e konstatimit. Masa e ndalesës për çdo muaj është 20 për qind e këstit mujor të trajtimit të veçantë. Personi që ka përfituar të ardhura në mënyrë e me mjete të padrejta, si dhe që nuk njofton ndryshimin ose heqjen e masës së tyre, detyrohet të kthejë të gjithë shumën e marrë tepër. Masa e ndalesës për çdo muaj është 50 për qind e këstit mujor të trajtimit të veçantë.

3. Në vitin 2008 vendimi nr. 11, datë 30.10.2001 për caktimin e përfitimit të veçantë për kërkuesin i është nënshtruar kontrollit nga auditi, që ka konstatuar parregullsi në lidhje me vjetërsinë në punë të kërkuesit. Për rrjedhojë, me vendimin nr. 2844, datë 15.05.2008 të DRSSH-së, Durrës, kërkuesit i është mbyllur përfitimi i trajtimit të veçantë dhe ai është shpallur debitor në shumën 441.806 lekë. Kërkuesi e ka kundërshtuar këtë vendim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila, me vendimin nr. 3548, datë 02.12.2008, ka vendosur vazhdimin e

përfitimit nga ai të trajtimit të veçantë, duke filluar nga data e ndërprerjes 30.10.2007 e në vazhdim. Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 17.12.2008 dhe në vijim DRSSH-ja, Durrës ka rifilluar pagesën e vlerës për trajtimin e veçantë.

4. Më pas, mbi kërkesën e kërkuarit, DRSSH-ja, Durrës, me vendimin nr. 42, datë 07.04.2015, duke u bazuar në pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, i ka caktuar kërkuarit pension pleqërie në vlerën 12.264 lekë në muaj, duke filluar nga data 16.12.2014. Nga kjo datë kërkuarit i është ndërprerë përfitimi i trajtimit të veçantë.

5. Në datën 27.04.2015 kërkuari i ka kërkuar DRSSH-së, Durrës rishqyrtimin e masës të trajtimit të veçantë. Në përgjigje, me shkresën nr. 4786, datë 30.07.2015, DRSSH-ja, Durrës ka refuzuar kërkesën e kërkuarit, me arsyetimin se për periudhën pas vitit 1993 nuk disponohej vërtetimi i pagës bruto dhe neto të tij, për pasojë trajtimi i veçantë që ai ka përfituar është llogaritur në vlerën minimale 5.148 lekë.

6. Në datën 16.04.2018 kërkuari i është drejtuar përsëri DRSSH-së, Durrës me ankesë dhe në përgjigje, me shkresën nr. 2289/1 prot., datë 25.04.2018, DRSSH-ja, Durrës i ka bërë të ditur se masa e trajtimit të veçantë, duke filluar nga data 16.12.2000, është përcaktuar në vlerën minimale, pasi për periudhën nga viti 1994 deri në vitin 2000 kontributet kanë qenë në vlerën minimale. Kërkuari ka paraqitur ankim administrativ në komisionin rajonal të ankimit të DRSSH-së, Durrës, i cili, me vendimin nr. 471, datë 07.11.2018, e ka rrëzuar kërkesën e kërkuarit.

7. Kërkuari e ka kundërshtuar këtë vendim në komisionin qendror të ankimit, i cili, me vendimin nr. 104, datë 04.02.2019, ka vendosur rrëzimin e kërkesës dhe lënien në fuqi të vendimin nr. 471, datë 07.11.2018 të komisionit rajonal. Në këto kushte, kërkuari i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për rillogaritjen e masës së përfitimit sipas ligjit nr. 8685/2000, në përputhje të plotë me vjetërsinë në punë, duke nisur nga dita kur i ka lindur e drejta ligjore për përfitim deri në marrjen e vendimit të formës së prerë nga gjykata, si dhe detyrimin për të paguar diferencën e pallogaritur të trajtimit ndër vite.

8. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2018-4494) 1407, datë 20.09.2018, ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, e cila, me vendimin nr. 137, datë 08.09.2020, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë dhe detyrimin e DRSSH-së të paguajë në favor të kërkuarit shumën 64.701 (gjashtëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e një) lekë, si diferencë të papaguar për efekt të përfitimit të trajtimit të veçantë si punonjës nëntoke vetëm për një vit dhe rrëzimin e padisë për pjesën tjetër. Gjatë gjykimit në shkallë të parë është caktuar

një ekspert kontabël për konstatimin e gabimeve në llogaritjen e masës së pagesës të trajtimit të veçantë si minator dhe të pensionit të pleqërisë dhe për llogaritjen e diferencave të papaguara. Sipas ekspertit, është konstatuar gabim në llogaritjen e masës të trajtimit të veçantë, duke iu caktuar një përfitim në vlerë më të ulët se masa e pensionit minimal të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Ndërsa në llogaritjen e masës së pensionit të pleqërisë nuk janë konstatuar gabime nga eksperti. Kërkuesi, pas përfundimeve të ekspertit, ka paraqitur kërkesë për saktësimin e objektit të padisë, duke përcaktuar vlerën 426.015 lekë si diferencë të krijuar për shkak të llogaritjes gabim të masës së përfitimit. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se e drejta për të kërkuar masën e përfitimit nuk parashkruhet, por përfitohet vetëm masa për një vit, për rrjedhojë gjykata e shkallës së parë në përfundim i ka njohur kërkuesit të drejtën për të përfituar diferencat e papaguara vetëm për periudhën 01.08.2013-01.08.2014, në vlerën 64.701 lekë.

9. Gjykata Administrative e Apelit, mbi ankimin e kërkuesit, me vendimin nr. 1339 (86-2024-1453), datë 16.07.2024 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 137, datë 08.09.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës me të njëjtën linjë arsyetimi. Ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-958, datë 03.03.2025, gjatë veprimtarisë seleksionuese ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

10. Në datën 26.05.2025 (*data e shërbimit postar*) kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual sipas objektit, i cili është regjistruar në datën 04.06.2025, pas plotësimit të dokumenteve sipas nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000.

II

Pretendimet e kërkuesit

11. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se:

11.1. *Është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi arsyetimi i gjykatave është arbitrar për shkak të mënyrës së interpretimit të nenit 6/1 të ligjit nr. 8685/2000, të ndryshuar. Kuptimi që i ka dhënë gjykata e shkallës së parë kësaj dispozite krijon një situatë paligjshmërie dhe pasigurie juridike, pasi DRSSH-ja dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH) mund të llogarisin në mënyrë të padrejtë të gjitha përfitimet që rrjedhin nga ligji dhe në përfundim edhe pse përfituesi do ta kundërshtojë në gjykatë nuk mund të përfitojë më shumë se vlerën për një vit. Të interpretosh nenin 6/1 të ligjit nr. 8685/2000, të ndryshuar, në mënyrën siç kanë bërë gjykatat e juridiksionit të

zakonshëm, do të thotë ta kthesh atë në një dispozitë që kundërshton vetë kuptimin dhe qëllimin e ligjit.

- 11.2. *Është cenuar e drejta e pronës*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, për shkak të interpretimit arbitrar të nenit 6/1 të ligjit nr. 8685/2000, të ndryshuar me ligjin nr. 9356/2005 në pjesën që parashikon “*jo më shumë se një vit*”. Sipas kërkesës, bazuar në këtë dispozitë rezulton se nëse trajtimi i veçantë është njohur dhe caktuar nga sigurimet shoqërore, por është paguar më pak, ky trajtim mund të jepet në çdo kohë, por jo më shumë se një vit. Në rastin konkret, kërkesit i është njohur e drejta për të përfituar trajtimin e veçantë nga DRSSH-ja, por ajo që është bërë në kundërshtim me ligjin lidhet vetëm me masën e pagesës së këtij trajtimi. DRSSH-ja ka bërë një pagesë në vlerë më të ulët dhe kërkesi mund të kërkojë diferencën vetëm për periudhën jo më shumë se një vit. Mosrespektimi i ligjit dhe moszbatimi i detyrave nga administrata mund të çojë në mohim të të drejtave, si dhe në dëme financiare të parikuperueshme për qytetarët.
- 11.3. Neni 6/1 i ligjit nr. 8685/2000, shtuar me ligjin nr. 9356/2005 në pjesën që parashikon “*jo më shumë se një vit*”, bie ndesh me nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkesës

12. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Në rastin në shqyrtim Kolegji vëren se kërkesi me anë të ankimit kushtetues individual ka kërkuar: (i) shfuqizimin e vendimeve gjyqësore; (ii) shfuqizimin e nenit 6/1 të ligjit nr. 8685/2000, të ndryshuar.

13. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara nga neni 71/a i ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Bazuar në nenet 49, pika 3, shkronja “e” dhe 71, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, objekt i ankimit kushtetues individual mund të jetë edhe ligji ose akti normativ. Në këto raste, Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se kërkuesi legjitimohet nëse plotëson bashkërisht këto kriterë: provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar (*ratione personae*); ka shteruar mjetet juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm, që do të thotë se për zbatimin e tij nuk është i nevojshëm miratimi i akteve nënligjore; ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit (*ratione temporis*); provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese (*ratione materiae*) (shih vendimet nr. 4, datë 21.01.2022; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

15. Në zbatim të këtyre standardeve, Kolegji vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae* në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet objekt kundërshtimi në Gjykatë, gjatë të cilit (procesit) është zbatuar edhe neni 6/1 i ligjit nr. 8685/2000, të ndryshuar.

16. Një tjetër kriter paraprak, që duhet të përmbushet nga individ i përpara se t’i drejtohet kësaj Gjykate, lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive* në dispozicion. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individ i pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Në të njëjtën linjë, neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000 përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuesi përpara se ai t’i drejtohet Gjykatës.

17. Ndërsa në lidhje me ankimin kushtetues individual, me objekt kundërshtimin si antikushtetues të ligjit, Gjykata ka theksuar se kërkuesi duhet t’i ketë përdorur të gjitha mjetet juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese që cenon ligji i kundërshtuar jo vetëm formalisht, por edhe në kuptimin substancial. Si rregull, ligji zbatohet përmes akteve të organeve publike ose vendimeve gjyqësore, prandaj individ duhet, së pari, t’i kundërshtojë ato përpara gjykatave kompetente, duke shteruar të gjitha mjetet juridike efektive që parashikon sistemi ynë juridik. Meqenëse mjeti juridik mund të jetë i ndryshëm, në varësi të llojit të ankimit, efektiviteti i tij vlerësohet jo thjesht nga fakti që është parashikuar me ligj, por edhe nga zbatueshmëria e tij (shih vendimin nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

18. Në rastin konkret, Kolegji vlerëson se kërkuesi e plotëson kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi i është drejtuar Gjykatës pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit, duke parashtruar pretendimet e tij. Për më tepër, argumentet në lidhje me pretendimin për antikushtetutshmërinë e dispozitës së kundërshtuar, kërkuesi i ka ngritur si në ankim ashtu dhe në rekurs, prandaj i vetmi mjet në dispozicion për rivendosjen në vend të të drejtave është ankimi kushtetues individual.

19. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Po kështu, neni 50, pika 4, i po këtij ligji parashikon se individët mund të paraqesin kërkesë për papajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara brenda 4 muajve nga konstatimi i cenimit. Pra, në rastin e ankimit kushtetues individual, konstatimi i cenimit, si rregull, nuk përkon me çastin e hyrjes në fuqi të ligjit ose aktit normativ, por afati ligjor llogaritet nga çasti kur akti fillon të prodhojë efekte për kërkuesin ose, e thënë ndryshe, kur ndaj tij zbatohet ligji ose akti normativ.

20. Në rastin konkret, kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit gjyqësor i dhënë në çështjen e tij, ku ka gjetur zbatim edhe dispozita e kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 03.03.2025, ndërsa ankimi kushtetues është paraqitur në Gjykatë në datën 26.05.2025, pra brenda afatit 4-mujor.

21. Për sa i përket legjitimitit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi në mënyrë të përmbledhur ka pretenduar se është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe e drejta e pronës për shkak të interpretimit arbitrar të ligjit, të nenit 6/1 të ligjit nr. 8685/2000, të ndryshuar, duke kërkuar në këtë kuptim dhe për të njëtat argumente edhe shfuqizimin e kësaj dispozite.

22. Kolegji konstaton se kërkuesi nuk ka parashtruar argumente në lidhje me të drejtën e pronës/pasuri, por nga natyra e mosmarrëveshjes së krijuar duket se ky pretendim lidhet me shumën e trajtimit të veçantë që ka përfituar si punonjës miniere, duke e konceptuar atë si të ardhur/pasuri. Prandaj, Kolegji vlerëson se nisur nga thelbi i argumenteve të parashtruara nga kërkuesi dhe referuar standardeve kushtetuese, do ta analizojë pretendimin për cenimin e së drejtës së pronës të lidhur me të drejtën për proces të rregullt ligjor. Gjithashtu, duke qenë se argumentet e paraqitura për shfuqizimin e dispozitës janë të njëjta me ato të procesit të rregullt ligjor, Kolegji do të vlerësojë në vijim nëse arsyetimi i vendimeve gjyqësore të kundërshtuara

është mjaftueshëm i qartë në përmbajtje, si dhe nëse interpretimi i ligjit nga gjykatat ka qenë ose jo arbitrar në këndvështrimin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor

23. Kërkuesi ka pretenduar se arsytimi i gjykatave është arbitrar për shkak të mënyrës së interpretimit të nenit 6/1 të ligjit nr. 8685/2000, të ndryshuar. Kuptimi që i kanë dhënë gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kësaj dispozite krijon një situatë paligjshmërie dhe pasigurie juridike, pasi DRSSH-ja dhe ISSH-ja mund të llogarisin në mënyrë të padrejtë të gjitha përfitimet që rrjedhin nga ligji dhe në përfundim edhe pse përfituesi do ta kundërshtojë në gjykatë nuk mund të përfitojë më shumë se vlerën për një vit.

24. Në lidhje me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, Gjykata ka theksuar se funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 45, datë 03.07.2017; nr.12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i takon vendimit të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, në jurisprudencë konstante të Gjykatës është pranuar se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të Gjykatës së Lartë gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 67, datë 03.10.2024; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata, po ashtu, është shprehur se nëse në vlerësimin e shkaqeve ligjore të rekursit dhe bazueshmërinë e tyre duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore, kolegji i Gjykatës së Lartë krijon bindjen se ato janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, ai vendos mospranimin e tij (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 9, datë 26.03.2018; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Po kështu, Gjykata në vijimësi është shprehur se zbatimi i ligjit është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm. Kjo do të thotë se Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e

arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që e bën të padrejtë gjykimin (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në rastin konkret rezulton se me vendimin nr. 11, datë 30.10.2001 DRSSH-ja i ka caktuar kërkuesit trajtimin e veçantë si minator nëntoke me datë fillimi 16.12.2000, në masën 5.148 lekë, për një periudhë të përgjithshme sigurimi 23 vjet, sipas ligjit nr. 8685/2000. Në nenin 2 të këtij ligji parashikohet se punonjësit që kanë punuar në miniera për një periudhë jo më pak se 11 vjet e gjysmë në nëntokë dhe kanë një periudhë sigurimi jo më pak se 23 vjet, në rastet kur nuk ushtrojnë veprimtari ekonomike, trajtohen me përfitim. Ndërsa sipas nenit 3 të ligjit masa e përfitimit për këta punonjës do të jetë e barabartë me 60 për qind të bazës së vlerësuar. Në rastet kur për llogaritjen e bazës së vlerësuar mungojnë dokumentet, masa e përfitimit do të caktohet në nivelin e përfitimit minimal, i cili përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Në zbatim të kësaj dispozite, VKM-ja nr. 73, datë 15.02.2001 ka përcaktuar se masa për nivelin minimal të përfitimit është 5.148 lekë. Në vijim, me vendimin nr. 42, datë 07.04.2015 të DRSSH-së kërkuesit i është caktuar pensioni i pleqërisë me datë fillimi 16.12.2014 në vlerën 12.264 lekë në muaj, bazuar në ligjin nr. 150/2014.

27. Ndërkohë, ligji nr. 8685/2000 ka ndryshuar me ligjin nr. 9356/2005, duke u shtuar neni 6/1 që mes të tjerave ka parashikuar se përfitimet e caktuara, sipas këtij ligji, rriten ose indeksohen sa herë dhe në atë masë që rriten ose indeksohen pensionet e pleqërisë nga sigurimi i detyrueshëm shoqëror. Përfitimet e caktuara, por të patërhequra, paguhen në çdo kohë, por jo më shumë se për 1 vit. Përfitimet e caktuara, por të paguara më pak, jepen në çdo kohë, por jo më shumë se për 1 vit. E drejta për të kërkuar shumat e marra tepër gjatë një viti ushtrohet jo më vonë se 3 vjet nga marrja e tyre, por jo më vonë se 6 muaj nga data e konstatimit.

28. Kërkuesi duke pretenduar se DRSSH-ja nuk i ka llogaritur masën e përfitimit sipas parashikimit të nenit 3 të ligjit nr. 8685/2000, të ndryshuar i është drejtuar gjykatës me padi me objekt rillogaritjen e masës së përfitimit sipas ligjit nr. 8685/2000 në përputhje të plotë me vjetërsinë e punës që nga dita kur i ka lindur e drejta ligjore për përfitim deri në marrjen e vendimit të formës së prerë nga gjykata, si dhe detyrimin për të paguar diferencën e pallogaritur të pensionit ndër vite në shumën 426.015 lekë (vlerë e saktësuar gjatë gjykimit, pas përfundimit të ekspertit kontabël). Si gjykata e shkallës së parë, ashtu edhe ajo e apelit kanë mbajtur qëndrimin se DRSSH-ja nuk ka marrë parasysh masën e pensionit minimal në shkallë vendi përgjatë kohës që kërkuesi ka qenë përfitues i trajtimit të veçantë dhe ai ka vijuar të marrë një masë nën vlerën e pensionit minimal në shkallë vendi, në kundërshtim me nenet 1 dhe 3 të ligjit nr. 8685/2000, ndonëse neni 3 i ligjit shprehet për përfitim minimal që përcaktohet me VKM. Gjykatat kanë vijuar në arsyetim se indeksimi ka filluar në vitin 2005 mbi vlerën 5.148 lekë,

pa marrë parasysh rritjet e bëra në pensionin minimal në shkallë vendi dhe që në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9356/2005, që ndryshoi ligjin nr. 8685/2000, pensioni minimal ka qenë në vlerën 7.266 lekë. Llogaritja jo e saktë e masës së trajtimit të veçantë të minatorit ka krijuar diferenca për periudhën nga 16.12.2000-16.12.2014 në vlerën 426.015 lekë. Por gjykatat e faktit kanë arsyetuar se pagesat nuk mund të kërkohen për të gjithë periudhën nga data e lindjes të së drejtës, pasi kufizimi është i caktuar me ligj, konkretisht në nenin 6/1 të ligjit nr. 8685/2000, të ndryshuar ku parashikohet se përfitimet e paguara më pak jepen në çdo kohë, por jo më shumë se për 1 vit. Në këto kushte, kërkuesit i është njohur e drejta për të përfituar vlerën 64.701 lekë për periudhën 01.08.2013-01.08.2014.

29. Ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, pasi ai nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në ligjin nr. 49/2012, të tilla që mund të cenojnë vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit.

30. Kolegji vlerëson se gjykatat e faktit kanë marrë në shqyrtim, analizuar dhe vlerësuar në mënyrë të argumentuar pretendimet e kërkuesit gjatë procesit gjyqësor dhe u kanë dhënë atyre përgjigje edhe në respektim të së drejtës së aksesit në gjykatë. Në këtë kuptim, ato kanë përmbushur detyrimin për arsyetimin e vendimit të tyre, ndërkohë që interpretimi nga ato i ligjit, i shprehur përmes arsyetimit, për sa i përket identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe në raport me të drejtën e kërkuesit, nuk rezulton i paarsyeshëm ose haptazi arbitrar në këndvështrimin kushtetues, në kuptimin që të bjerë ndesh me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës.

31. Për sa i takon vendimit të Gjykatës së Lartë, Kolegji vëren se në pjesën hyrëse të tij përshkruhen vendimet e gjykatave të faktit dhe listohen shkaqet e rekursit. Prandaj duke pasur parasysh natyrën e vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Lartë, përmes të cilit, në kuadër të verifikimit të kriterëve të pranueshmërisë së rekursit të kërkuesit, është vendosur mospranimi i tij, pavarësisht arsyetimit të kufizuar në lidhje me pretendimet e kërkuesit, Kolegji vlerëson se, në kundërshtim nga sa kërkuesi pretendon, arsyetimi i këtij vendimi nuk rezulton në cenim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, sipas jurisprudencës kushtetuese.

32. Nisur nga kjo, Kolegji vlerëson se vendimet e gjykatave të zakonshme nuk cenojnë standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit në këtë drejtim është haptazi i pabazuar.

33. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.